



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër 02-01/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Leonard Lllolluni - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	02.02.2026
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së parë (1), të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 02.02.2026, duke filluar në ora 14:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Leonard Lllolluni: i cili në fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, më pas e konstatoi se prezent në sallën e kuvendit janë 12 antaret e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Anëtarët prezent

1. Leonard Lllolluni-Kryesues, AAK
2. Bedrush Hoxha-anëtar, LDK
3. Litafete Isufa-anëtare, LDK
4. Shpejtim Gacaferi- anëtar, LDK
5. Sadri Krasniqi- anëtar, LDK /**Mungon**/
6. Floris Miroci-anëtar, LDK
7. Blerta Sylja-anëtare, LDK
8. Burim Kuçi-anëtar, AAK
9. Ajshe Gacaferi-anëtare, AAK
10. Aldi Gacaferi-anëtar, AAK
11. Arlinda Pepshi-anëtare, AAK /**Mungon**/
12. Alfred Gaxherri-anëtar, AAK
13. Jetmir Tofaj-anëtar, LVV
14. Elsa Hima-anëtare, LVV
15. Lulzim Gacaferi-anëtar, LVV /**Mungon**/

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Caktimi i shefave te grupeve të subjekteve politike në Kuvendin e komunës së Junikut,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i orareve për mbledhjet e rregullta të kuvendit Komunal dhe te KPF_së për vitin 2026, si dhe përzgjedhja e grupit punues për planin e punës së kuvendit për vitin 2026,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për inicim të procedurave për plotësim dhe ndryshim të rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për listën e përgjithshme dhe listën e veçantë të pronave të palujshme që planifikohen për dhënje në shfrytëzim,
6. Formimi i Komitetit për Politik dhe Financa (KPF),
7. Formimi i Komitetit për Komunitete,
8. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar-Dhjetor 2025
9. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat dhe vërshimet,
10. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe
11. Të ndryshme

Para se të hudhet në votim rendi i ditës fjalën e kërkoj z.Shpejtim Gacaferi.

z.Shpejtim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, çdo vendim që nxirret në kuvend duhet të nënshtrohet ligjshmeris nga ana e ministris përkatëse, vendimi ka shkuar në ministri dhe une nuk e di se a të është kthyer, dhe si do që të jete ky vendim si pozitiv apo edhe negativ është mire që të njoftohet ky kuvend, në qofte të është kthyer pozitivisht edhe në mënyrën gojore në rregull e vazhdojmë mbledhjen por në qofte se nuk është kthyer apo është kthyer negativ atëherë është mire që ta ndërpresim mbledhjen, apo nëse nuk është as një dhe as tjetër atëherë nuk janë bërë tridhjetë (30) dite, neve na duhet të presim tridhjetë (30) dite sepse ashtu është e rregulluar me ligje, që në afatim prej tridhjetë (30) ditëve në qofte se nuk kthehet vendimi konsiderohet e ligjshëm.

z.Leonard Lolluni, sa i përket ligjshmeris, une kam qene në komunikim me ministri e pushteti lokal dhe me kanë thënë me vazhdu me punimet, por edhe vendimin për ligjshmerin kemi me e patur shumë shpejt por po ashtu ju e dini se nëse nuk na vije asnjë vendim kjo heshtje konsiderohet e ligjshme.

z.Shpejtim Gacaferi, sa i përket rendit të ditës të pika e dyte (2) caktimi i shefave të grupeve të subjekteve politike të Kuvendit Komunal, është e specifikuar në neni 71 të rregullores së punës së kuvendit, aty thuhet se kryesuesin e kuvendit subjekte e përfaqësuara në kuvend e njoftojnë në formë të shkruar për shefat e grupeve të subjekteve politike, kjo pikë nuk ka nevojë të shqyrtohet, po ashtu edhe të pika e tretë (3) miratimi i orareve të mbledhjeve të rregullta, është e

rregulluar ne rregulloren e punës se kuvendit nen 22 pika 3 ku thotë se plani i punës se kuvendit nen udheheqeje e kryesuesi te kuvendit themelohet grupi punues i cili e pergadite plani vjetore te punës se bashku me orarin e takimeve ku paraprakisht konsultohen kryetari komunës dhe drejtoret e drejtoriave komunale, andaj une konsideroj qe këto dy pika te rendit te ditës te hiqen ga rendi i ditës.

z.Leonard Lolluni, sa i perkete caktimit te shefave te grupeve te subjekteve politike te përfaqësuar ne kuvend, edhe ne mandati kur ti ke kryesuar me kete kuvend i kemi caktuar këtu ne kuvend dhe ligji nuk e thotë se nuk bon te zgjidhen ne kete menyre, por mundet edhe ne menyre e shkruar te dërgohet emrimi i shefit per ate grup te caktuar, shefat e grupeve nuk votohen por vetëm deklarohen, ndërsa sa i perkete orarit te mbajtjeve te mbledhjeve, une e di se ka nje plan pune te kuvendit te miratuar por ate plan nuk e kam gjetur andaj e qes ne votim kete rend te ditës kush eshte per kete rend te ditës, per 7 vota, kundër 5 vota dhe apstenime 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Leonard Lolluni, kerkese nuk ka e hudhi ne votim procesverbali nga mbledhja e kaluar, kush eshte per, per 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali u miratua.

2. Caktimi i shefave te grupeve të subjekteve politike në Kuvendin e komunës së Junikut,

z.Leonard Lolluni, ju njoftoj se shefat e grupeve te subjekteve politike vetëm deklarohen nuk votohen, grupi i LDK_se do te deklarohet me shkrim
grupi i AAK_se deklarohen per z.Burim Kuçi
grupi i LVV_se deklarohet per z.Jetmir Tofaj

3. Shqyrtimi dhe miratimi i orareve për mbledhjet e rregullta të kuvendit Komunal dhe te KPF_së për vitin 2026, si dhe përzgjedhja e grupt punues per plani e punës se kuvendit per vitin 2026,

Prezentimin dhe arsyetimin e kësaj pike e beri kryesuesi i Kuvendit z.Leonard Lolluni.

z.Bedrush Hoxha, përshëndetje per te gjithë, kryesues une mendoj se per kete plan te punës se kuvendit duhet te bashkëpunosh me kryetari e komunës.

z.Shpejtim Gacaferi, te muaj shtator ne qofte se bene eshte mire te ndryshohet data e mbajtjes se mbledhjes qe eshte me 28 shtatore, arsyjen e kësaj veq se e dini, qe ti ipet hapsir ekzekutivit ne qofte se ne si kuvend nuke miratojmë buxhetin andaj kërkoj qe kjo date te jete me e hershme se 28 shtatori.

z.Leonard Lolluni, ne rregull ne mundemi ta zhvendosim me date 25 shtatore e premtë mbledhjen e kuvendit ndërsa te KPF me date 17 qe i bie e Premte po ashtu.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për të gjithë, a ka parapar që kuvendi të ketë pushim gushtin.

z.Shpejtim Gacaferi, grupi hartues gjatë punimeve i diskuton të gjitha këto dhe me siguri që muajn gushtë e vendosin të ketë pushim sepse nuk është e thënë që kuvendi të mbaje dymbëdhjetë (12) takime pra me ligje thuhet jo me pak se dhjetë (10) mbledhje dhe jo me pake se pesë (5) në gjashtë (6) muajorin e parë, andaj unë kërkoja që fillimisht të formohet grupi punues për hartimin e planit të punës.

z.Ruzhdi Shehu, unë kërkoj që të mos kapërcemë norma për mos respektim të normës me mirë është që të formohet e grupit punues.

z.Leonard Lolluni, atëherë jemi të propozimet nga subjekte për antaret e tyre që do të kenë në grupin punues për planin e punës së kuvendit për vitin 2026:

LDK propozon z.Floris Miroci

AAK propozon z.Aldi Gacaferi

LVV propozon znj.Elsa Hima

Ekzekutivi propozon znj.Leonora Shehu

E hundi në votim këtë grup punues kush është për, për 12 vota, kundër 0 vota dhe anshëm 0 vota konstatoi se grupi punës për planin e punës së kuvendit për vitin 2026 u miratua.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për iniciim të procedurave për plotësim dhe ndryshim të rregullores Komonale për menaxhimin e mbeturinave,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj rregullore e bëri z.Demokrat Ganijaj, UD i drejtorit për DSHPMI i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit këtë rregullore.

z.Leonard Lolluni, meqë është vetëm iniciim për plotësim ndryshim të rregullore unë e qes në votim këtë propozim kush është për, për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se u miratua fillimi i plotësim ndryshimit të rregullore për menaxhimin e mbeturinave.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për listën e përgjithshme dhe listën e veçantë të pronave të palujshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim

Arsyetimin dhe sqarimin e bëri z.Zenun Shala UD i drejtorit për DUKM i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e arsyetoi dhe e sqaroi vendimin për listën e përgjithshme dhe listën e veçantë të pronave para anëtarëve të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkoj një sqarim nga drejtori se për sa vite është parapar që këto prona të i pëne në shfrytëzim, po ashtu kërkoj që nga lista 01036-1 të hiqet nga lista, edhe pse nuk ka patur kërkesë kërkoj që kjo ngasë të largohet nga lista pasi që kemi probleme me këtë ngastër.

z.Zenun Shala. Lista e veçantë e pronave që planifikohen të i pëne në shfrytëzim, vare nga kërkesat që do të kemi nga individët apo firmat që do të kenë interes për këtë prona, kjo ngastër në fjale është në lagjen Pepsh aty ku më parë ishte fusha sportive, andaj çdo kërkesë para do të vijë këtu në kuvend për miratim.

z.Jetmir Tofaj, përshëndetje për të gjithë, këtu e kemi listën e përgjithshme dhe listën e veqanet të pronave që parashihen për dhenje në shfrytëzim, këtu kemi certifikatën e pronsis, ngasra, sipërfaqe metra katrore, kultuar dhe vendi i quajtur, si psh bria Qafa e Jasiqir, por për korreksit dhe për informim ma të mirë për ne si kuvendar a është e mundur që në këto liste të vendosen edhe koordinata e pronave.

z.Zenun Shala, po kjo është e mundur, por shumica e këtyre pronave në këtë listë janë varreza, rruge, por nëse ka të interesuar në pe rate prone që është i interesua munëmi tja japim koordinatat.

z.Leonard Llojuni, këto liste e kemi miratuar çdo vitë nëse ka të interesuar kërkesa prap vjen për miratim këtu në kuvendin atdhej unë e qen në votim miratim dhe vendimi për listën e përgjishme dhe të listën e veqante të pronave të palijshme që planifikohen për dhenje në shfrytëzim kush është për , për 12 vota, kundër 0 vota dhe anësim 0 vota, konstatoi se lista e përgjishme dhe lista e veqanete e pronave për dhenje në shfrytëzim u miratua.

6. Formimi i Komitetit për Politik dhe Financa (KPF),

Sqarimin dhe arsyetimin formimit të këtij Komiteti e bëri Kryesuesi i Kuvendit.

LDK propozon z.Bedrush Hoxha dhe znj.Litafete Isufaj

AAK propozon znj.Ajshe Gacaferi

LLV propozon z.Jetmir Tofaj

z.Leonard Llojuni, Komiteti për Politik dhe Financa do të ketë përbërje:

z.Leonard Llojuni AAK- kryesues

z.Bedrush Hoxha LDK- anëtar

znj.Litafete Isufaj LDK-anetare

znj.Ajshe Gacaferi AAK- anetare

z.Jetmir Tofaj LVV- anëtar

e qesim në votim këtë përbërje të KPF-se, kush është për, për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstënim 0 vota, konstatoi se KPF u miratua.

7. Formimi i Komitetit për Komunitete,

Sqarimin dhe arsyetimin e formimit të Komitetit për Komunitete e bëri kryesuesi i Kuvendit.

Propozimet nga Kuvendi: LDK propozon z.Floris Miroci

AAK propozon z.Alfred Gaxherri

LVV propozon znj. Elsa Hima

Qitet në votim propozimet e anëtarëve nga kuvendi që do të jenë në përbërje të Komitetit për komunitete kush është për këto propozime, për 12 vota , kundër 0 vota dhe abstënim 0 vota konstatoi se këta tre anëtarë të kuvendit për Komitetin për Komunitet u miratua.

8. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar-Dhjetor 2025

Arsyetimi dhe sqarimin e raportit financiar janar-dhjetor 2025 e beriznj.Ardita Hoxha UD e drejtoreshës per DBF e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi kete raport para anetrave te kuvendit.

z.Leonard Lolluni, siq e dini raportet vetëm shqyrtohen nuk votohen meqë nuk ka asnjë kerkese tjetër kalomë ne piken e radhës se redit te ditës.

9. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat dhe vërshimet,

Arsyetimin dhe sqarimin e raporti per vlersimin e dëmeve te shkarkuara nga reshurat dhe vërshimet e beri z.Shkelzen Shehu, kryesuesi i komisionit per Vlersimin e dëmeve te ngritur me vendim te Kryetarit te Komunes, z.Shehu fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi raportin para anetarve te Kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, siq e dimë materiali per kete pike na ka ardhur me vonës dhe une tash e pashe te gjithë materialin dhe une nuk do te mare pjese as ne diskutim por as ne votim per kete raport vlersimi pasi qe paraqet konfilik interesi.

z.Burim Kuçi, përshëndetje per te gjithë, une dua ta pyes z.Shkelzen Shehu, ne raport po shihet gjendja reale ne baze te fotove por mua po me intereson kërkesat e qytetarve qe kan ber a kane fotografi te bashkangjitur dhe o ishte mire qe këto fotografi ti bashkangjiten keti raporti. Dhe a shkon si pako apo e ndrase ky raport ne qeveri?

z.Shkelzen Shehu, secila kerkes ka nga pese (5) fotografi te bashkangjitura, por per kuvend nuk kemi dashur ta ngarkojmë materiali me shume per kuvendi, por ne raportin final qe do ti dërgohet qeveris per vlerësim do te jene edhe këto kërkesa me fotografi dhe vlerësim, dhe ky raport shkon ne pako.

z.Jetmir Tofaj, faleminderit kryesuesit te keti komisionit per kete raport, tek dëmtimet infrastrukture ne rrugën Junik-Rastavice, me sa mbaj ne mende ne kontratën e nënshkruar nga kryetari i Komunes dhe operatorit ekonomik ka pas qene e parapare dhjete (10) kilometra pankine qe i bije ne dy anët e rrugës nga pese (5) kilometra, ndërsa këtu ne raport po shihet se ka nje dëme afër ODA resdicens, dhe ky dhjete(10) kilometere pankine nuk eshte realizuar, nuk e di se si eshte bere pranimi i punëve apo ka pasur ndryshim pozicioni, edhe pyetja e dyte, tek shtrati i lumit Erenik qe i keni paraprezentuar te dhënat, keni parapare edhe ndërtim te pendës se ujitjes ne vlere prej 120000€, a lejohet kjo ne kete raport te vlersimeve te dëmeve, a ka ekzistuar kjo pende dhe eshte dëmtuar, mundësisht nje sqarim.

z.Ruzhdi Shehu, penda ka qene dhe eshte dëmtuar kohe pas kohe, dhe nëse e shohin riparimet ne shtratin e lumit Erenik janë te pa efekshme.

z.Jetmir Tofaj, riparimet do te rrisin sa do pake sigurin e atyre kalimtarve qe e frenkutojne këto hapsira gjate shtratit te lumit Erenik, secili riparim e do te ishte i mire por rikonstruimi i plote do te ishte me se mirt por kjo varet edhe nga buxheti i komunës.

z.Leonard Lllolluni, une shpresoj qe qeveri e kosoves do ta mbështes kete raport, këto dëme janë evidente she uroje qe qeveria do ta ndimjoj komunën, dhe meqë kërkohet ndime finaciare ky raport duhet te votohet andaj e qes ne votim raporti e vlersimeve te dëmeve qe shkatuara nga te reshurat dhe vërshimet, kush eshte per, per 11 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se raporti i vlersimit u miratua.

10. Pyetje nga anetaret e Kuvendit

Nuk ka pyetje

11. Te ndryshme

z.Shpejtim Gacaferi, si keshille kryesues, ftesa per mbledhje duhet ti shkoje edhe drejtorve bashk me materiali siq na vie neve anetarve te kuvendit, po ashtu ftese mund te zgjedhësh te ju shkoje eshë policisë se kosoves, OSBS, KFOR , e ke obligim ne baze te rregullore se punës se kuvendit pra shtate (7) dite para mbledhjes.

z.Leonard Lllolluni, une per kete mbledhje e kam njoftuar Kryetarin e Komunes përmes e _mail, po ashtu kam ofruar bashkëpunim per secilën piket te rendit te ditës, dhe tani e tutje i njoftoj edhe secili drejtor.

z.Jetmir Tofaj, kërktoj qe anetaret e kuvendit te kenë edhe e _mail zyrtar nuk e di se pse nuk kemi deri tanin këto e _mail, do te ishte me e letë ta prananim materiali per mbledhje dhe komunikimi do te ishte me i letë, po ashtu kerkoje qe çdo mbledhje e kuvendit te transmetohet live ne web-faqen e Komunes, ne rrjetet sociale, komunat tjetra e kane kete praktik dhe mendoj se eshte ma transparente dhe qytetaret mund ta shohin efikasitetin apo edhe jo efikasitetin e kuvendarve qe ata i kane zgjedhur dhe i kane besuar qe ti përfaqësojnë ne kuvend.

z.Leonard Lllolluni, e _mail zyrtare e ka per detyre IT i komunës me na i siguruar kështu ka qene praktike me herët, dhe me sa jame ne dijoni ato shume shpejt do ti kemi dhe po sa ti kemi une materialin dhe ftetat per mbledhje do ta jau dërgoj përmes e _mailit, ndërsa sa i perkete teleprezences, teleprezenca eshte prezent, ne te ardhmen mendoj se do ta kemi nje web-faqe zyrtare te kuvendit dhe aty qytetaret do te munde ta ndjekon mbledhjen live.

znj.Leonora Shehu, përshëndetje per te gjithë , sa i perkete transmetimit live te mbledhjesve te kuvedit qytetaret e kane kete munds qe përmes web-faqes se komunës ka ndjekin mbledhjen.

z.Leonard Lllolluni, kerkese tjetër nuk ka e shpalli te mbyllur mbledhjen e pare(1).

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit

z. Leonard Lllolluni

